



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P 703/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	NënKryetar
Vima Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.11.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave standarte të tenderit për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*”, me Nr. REF- 36051-09-16-2019, me objekt “*Shërbim Privat të Sigurisë Fizike të DSHS-Kurbin*”, me fond limit 3,352,000 lekë pa tvsh, publikuar më datë 17.09.2019 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kurbin.

Ankimues: “Guard & Protect Rica” shpk
Adresa: Lagjia Nr. 1, Pallati 9-katësh, Kati 9, Laç.

Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kurbin.
Adresa: Lagjia Nr. 4, Laç - Kurbin.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.09.2019 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*”, me Nr. REF- 36051-09-16-2019, me objekt “*Shërbim Privat të Sigurisë Fizike të DSHS-Kurbin*”, me fond limit 3,352,000 lekë pa tvsh, publikuar më datë 17.09.2019 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kurbin.

II.2. Në datën 20.09.2019, operatori ekonomik “*Guard & Protect Rica*” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

Me date 17.09.2019 jemi njohur elektronikisht ne faqen zyrtare eëë.app.gov.al, me DST-ne e procedures se prokurimit me objekt “Sherbimin Privat te Sigurise Fizike te DSHS – Kurbin” e organizuar nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kurbin parashikuar per tu zhvilluar ne daten 27.09.2019 ora 10:00. Nga shqyrtimi me kujdes i kesaj DST-je konstatuam se disa kriteret e vendosura nga Autoriteti Kontraktor jane ne kundërshtim me rregullat e miratuara te prokurimit publik. Per arsyen e lartepërmendur ne mbështetje te Ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 63 pika 1/1 “Te drejtat e personit te interesuar” po ju dergojme kete ankese duke ju parashtruar kundërshtimet tone si vijon:

1. Ne DST-ne e kesaj procedure Shtojca 8 Kriteret e Pergjithshme te Pranimi/Kualifikimit ne Seksionin Kapaciteti Teknik pika 1 germa b shpreheni:

- Kur sherbimi i se njejtës natyre është realizuar me subjekte private operatori ekonomik do ta vertetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën e lidhur me subjektet private të shoqëruar me faturën perkatese tatimore të shities dhe të shoqëruar detyruesisht me vertetimin e leshuar nga subjekti privat për realizimin e sukseshëm të kesaj kontrate.

1.1 Duke iu referuar VKM Nr.914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, nëni 28 pika 3 paragrafi 3 shprehimisht thuhet:

Ne rastin e përvosjes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shities, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Duke iu referuar kriterit të vendosur nga ana juaj dhe normes ligjore të miratuar me VKM e sipërcituar sqarojmë, se kur bëhet fjalë për shërbime të realizuara me sektorin privat pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes dhe jo vertetime për realizimin e këtyre kontratave.

Për sa thame më lart i kërkojmë Autoritetit Kontraktor të modifikojë kriterin e mësipërm duke hequr kërkesën për paraqitje të vertetimit nga subjektet private, në përputhje me përcaktimet e VKM nr. 914.

2. Ne DST-ne e kesaj procedure Shtojca 8 Kriteret e Pergjithshme te Pranimi/Kualifikimit ne Seksionin Kapaciteti Teknik pika 2 shpreheni:

1. Vertetim performance nga Dreitoria e Policisë së Qarkut Lezhë leshuar në vitin 2019 e cila duhet të përmbajë të dhënat
 - listën e punoniesve të shërbimit të certifikuar jo më pak se 5 punonies, dhe vëshmerinë e këtyre certifikatave - datën e certifikimit (datën e leshimit).
 - përgjegjësinë shërbimi jo më pak se 1 punonies.
 - grupin i gatshëm 24 në 24 orë për nënkategorinë 1.3.A të specifikuar në performancën e subjektit. jo më pak se 5 punonies shërbimi.
 - Qendër Kontrollit të Shërbimit në funksion 24 orë/7 ditë në Qarkun e Lezhës me jo më pak se 5 punonës/operator, shoqëruar me Akt Miratimitin e Qendrës Kontrollil nga DVP Lezhë.
 - automjetet shërbimi jo më pak se 1.
 - nuk ka masë administrative.
 - nuk ka ngjarje të ndodhura

2.1 Duke iu referuar fondit limit dhe përshkrimin apo objektin të kontratës ku kemi të bëjmë me shërbim ruajtje me roje private dhe ndërkohë që A.K kërkon grupe të gatshme duke dalë jashtë objektit të kontratës që prokurori pasi sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin privat të sigurojë fizikisht grupet e gatshme shërbëjnë për verifikimin e sinjaleve të alarmit shërbim që

ne kete kontrate as nuk eshte percaktuar dhe as nuk eshte parashikuar fond limit per kete sherbim. Pra eshte nje kriter i tepert dhe pa asnje lloj lidhje me kontraten qe Autoriteti juaj Kontraktor po prokuron.

2.2 Gjithashtu kerkohen jo me pak se pese punonjes sherbimi operator po ti referohemi nenit 46/1 te L.P.P kriteret duhet te vendosen ne perputhje dhe ne perpjestim te drejte me kontraten qe prokurohet pra kemi nje vendroje nje operator duhet te kerkoje autoriteti kontraktor. Kerkesa e mesiperme eshte e ekzagjeruar dhe diskriminuese per sa kohe ne kete objekt do te kryejne sherbim 4.98 punonjes.

Per sa thame me lart i kerkojme Autoritetit Kontraktor te heqe kerkesen e grupeve te gatshme nga kriteri i mesiperm, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Argumenti yne eshte i bazuar ne Udhezimin e Ministrit te Brendshem nr.130 date 05.03.2018. Kreu V Menaxhimi i Sherbimeve te Shpsf-se germa A pika 13, ku percaktohet qarte funksioni i grupeve te gatshme. Gjithashtu i kerkojme A.K ne perputhje me nenin 46/1 te L.P.P te modifikoje numrin e operatoreve te kerkuar nga 5 ne 1, ne perpjestim te drejte me kontraten qe prokuron.

3. Ne DST-ne e kesaj procedure Shtojca 8 Kriteret e Pergjithshme te Pranimi/Kualifikimit ne Seksionin Kapaciteti Teknik shpreheni:

- Operatori ekonomik duhet te kete ne pronesi minimum 2 Arme Brezi te vertetuar me:
- Autorizim per Blerie Arme nga Dreitoria Pergjithshme e Policise.
- Kontrate Shitblerie Armesh me shoqeri te Licensuar shoqeruar me nr serial te armeve.
- Faturat Tatimore dhe Mandat pagesat e Bankes.

3.1 Duke iu referuar kriterit te vendosur nga ana juaj dhe mbeshtetur ne ndryshimet ligjore per rregjimin e armeve dhe rekomandimeve e udhezimeve te A.P.P-se e K.P.P-se, sqarojme se te gjitha kerkesat e mesiperme jane jo ligjore dhe jane hequr nga DST e procedurave te sherbimit privat te ruajtjes prej disa vitesh.

Per sa thame me lart i kerkojme Autoritetit Kontraktor te heqe kerkesat e paraqitjes se dokumentacionit ligjor te posedimit te armeve ne teresi, ne perputhje me ndryshimet ligjore ne fuqi.

4. Ne DST-ne e kesaj procedure Shtojca 8 Kriteret e Pergjithshme te Pranimi/Kualifikimit ne Seksionin Kapaciteti Teknik pika 9 shpreheni:

9. Specifikimet per Sistemet e Alarmit

Operatori ekonomik duhet te kete te instaluar salle te monitorimit per marrjen e sinjaleve ne raste zjarri, tymi ne objekt.

Te disponoje dhe te kete ne gadishmeri grup per verifikimin e sinjaleve dhe te siguroje prezencen e tij ne objekt.

Te disponoj 1 mjet per levizjen e grupit te verifikimit te sinjalit.

4.1 Sic u shprehem dhe me siper ne ankesen tone objekti i kesaj kontrate eshte sherbim ruajtje dhe jo verifikim sinjalesh me grupe te gatshme. Gjithashtu edhe fondi limit eshte parashikuar per sherbim ruajtje te objekteve dhe jo per verifimi te objekteve me sinjal alarmi dhe grupe te gatshme. Ndaj gjykojme se kriteret e mesiperme nuk kane lidhje me proceduren ne fjale kjo duke iu referuar fondit limit objektit te kontrates por edhe specifikimeve teknike e Formularit te Ofertes ku ne asnje rast ne keto elemente thelbesore nuk eshte percaktuar se sherbimi do te kryhet ne dy menyra ruajtje e verifikim sinjalesh.

- Per sa thame me lart i kerkojme autoritetit kontraktor te heqe ne total kerkesat e pikes 9 ne respekt e zbatim te legjislacionit ne fuqi.

Ne permbledhje te argumentave tona te lartpermendura dhe ne mbeshtetje te Ligjit nr/9643 dt 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar kerkojme nga Institucioni juaj qe:

- Pezullimin e cdo faze te prokurimit derisa ankesa jone te jete shqyrtuar teresisht.
- Marrjen parasysh te ankeses tone.
- Modifikimin dhe heqjen e kriterëve te kundërshtuar nga shoqëria jone.
- Publikimin e te gjitha ndryshimeve te DST-se ne www.app.gov.al.

II.2.1. Në datën 24.09.2019, me shkresën nr. 19/8 prot, operatori ekonomik "Guard & Protect Rica" shpk, është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.2.2. Në datën 01.10.2019, pala ankimuese operatori ekonomik "Guard & Protect Rica" shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.3. Me shkresën me nr. 231/1 prot, datë 15.10.2019, protokolluar me tonën me nr. 1550/2 prot, datë 15.10.2019, me objekt "Informacion" është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Guard & Protect Rica" shpk "per paraqitje vertetimi nga subjektet private, ne perputhje me percaktimet e VKM nr. 914, në lidhje me vërtetimin e punëve të ngjashme nga subjektet private". KPP, referuar informacionit

të autoritetit kontraktor të administruar në dosjen objekt shqyrtimi, parashtrimeve me shkrim të ankimuesit, trajtimin të kërkesës nga ana e autoritetit kontraktor si edhe shtojcës mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit publikuar nga autoriteti kontraktor në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, kostaton se nga ana e autoritetit kontraktor është pranuar kërkitimi i mësipërm i operatorit ekonomik ankimues në lidhje me heqjen e vertetimit të realizimit nga subjektet private nga shtojca e dokumentave të tenderit. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, KPP konstaton se, nga e autoritetit kontraktor është reflektuar në sistemin e prokurimeve elektronike ndryshimi përkatës (shtojcë e dokumenteve të procedurës së prokurimit) në lidhje me vendimarrjen e KSHA. Pra, sa më sipër, autoriteti kontraktor në lidhje me pretendimin e mësipërm ka pranuar ankesën dhe ka publikuar shtojcën me ndryshimet përkatëse, në sistemin e prokurimeve elektronike. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, duke qenë se ankesa e operatorit ekonomik “Guard & Protect Rica” sh.p.k. në lidhje me pretendimin e mësipërm, është pranuar nga autoriteti kontraktor, dhe janë pasqyruar edhe ndryshimet përkatëse, në SPE në shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit, rrjedhimisht ky pretendim nuk do të merret në shqyrtim në themel, pasi nuk eksiston më si objekt ankimi.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Guard & Protect Rica” sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: *“kerkohen jo me pak se pese punonjes sherbimi operator po ti referohemi nenit 46/1 te L.P.P kriteret duhet te vendosen ne perputhje dhe ne perpjestim te drejte me kontraten qe prokurohet pra kemi nje vendroje nje operator duhet te kerkoje autoriteti kontraktor. Kerkesa e mesiperme eshte e ekzagjeruar dhe diskriminuese per sa kohe ne kete objekt do te kryejne sherbim 4.98 punonjes.”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2 “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin si më poshtë vijon:

Vërtetim performance nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Lezhe leshuar ne vitin 2019 e cila duhet te permbaje te dhenat

- *listen emerore te punonjesve te sherbimit te certifikuar jo me pak se 5 punonjes, dhe vleshmerine e ketyre certifikatave – daten e certifikimit (daten e leshimit),*
- *pergjegjes sherbimi jo me pak se 1 punonjes*
- *grup i gatshem 24 ne 24 ore për nënkategorinë 1.3.A i specifikuar në performancën e subjektit, jo më pak se 5 punonjës shërbimi.*
- *Qender Kontrollit te Sherbimit ne funksion 24 ore/ 7 dite ne Qarkun e Lezhës me jo me pak se 5 punonjes/operator, shoqeruar me Akt Miratimitin e Qendres Kontrollit nga DVP Lezhe*
- *automjete sherbimi jo me pak se 1*
- *nuk ka mase administrative*
- *nuk ka ngjarje te ndodhura*

III.2.2. Në shtojcën 8 “Specifikimet teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet:

Kontrata do të lidhet për 4.98 (katër presje nëntëdhjetë e tetë) punonjës për një periudhë 12 Mujore nga momenti i nënshkrimit të Kontratës.

III.2.3. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 1 “Formulari i ofertës”, autoriteti kontraktor ka parashikuar kryerjen e shërbimit si më poshtë vijon:

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
	“Shërbimi i Ruajtjes dhe sigurisë fizike të ambienteve të DSHS-Kurbin” Sipas Grafikut	4.98			12 Muaj
Çmimi Neto)					
TVSH (%)					
Çmimi Total					

III.2.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

III.2.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 5, parashikohet si më poshtë: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.2.6. Në Udhëzimin e Ministrit të Punëve të Brendshme Nr.130, datë 05.03.2018 “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, Kreu V “Menaxhimi i Shërbimeve të SHPSF-së”, në pikën 11 dhe 13 është parashikuar:

11. Veprimtaria e SHPSF-së realizohet nëpërmjet organizimit të shërbimit me:

- a) roje objekti për ruajtjen fizike;
- b) truproje për ruajtjen e personave;
- c) sisteme sinjalizuese elektronike për ruajtjen e objekteve;
- d) punonjës shërbimi operator në qendrën e kontrollit;
- e) punonjës shërbimi për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë të lidhura me sisteme elektronike;
- f) përgjegjës shërbimi;
- g) punonjës shërbimi (shofer) për drejtimin e automjetit;
- h) punonjës shërbimi për drejtimin e motoçikletës;
- i) shoqërues i qenit të shërbimit.

13. Për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë lidhur me këto sisteme, SHPSF-ja detyrohet të mbajë të gatshëm një grup punonjësish me përbërje jo më pak se 2 (dy) punonjës për çdo turn. Koha e reagimit përcaktohet në kontratën e lidhur mes palëve.

III.2.7. Në lidhje me pretendimet e mësipërme, të operatorit ekonomik ankimues i cili ka parashtruar dhe kërkuar uljen e numrit të operatorëve të qendrës së kontrollit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese” b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë përmasat e kontratës që do të prokurohet siç është përcaktuar edhe në rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se në respekt të testit të proporcionalitetit, referuar nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, përse i përket pretendimit të ankimuesit për uljen e numrit të operatorëve të qendrës së kontrollit, që në rastin konkret janë kërkuar 5 operatorë, KPP gjykon se, nisur nga shërbimi i kërkuar nga autoriteti kontraktor për 1 vendroje me tre turne me 4.98 roje, si dhe rëndësia e objektit që kërkohet të ruhen, kërkesa për 5 operatorë në qendrën e kontrollit është një kërkesë e drejtë dhe në përputhje me objektin dhe shërbimin e kërkuar për këtë procedurë prokurimi dhe në përputhje me nenin 46 të ligjit për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të vërtetojë se operatori ekonomik disponon kapacitete teknike (në rastin konkret

kapaciteti për operator për qendrën e kontrollit), mjaftueshëm sa të jetë në gjendje të realizojë kontratën objekt i këtij prokurimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “Guard & Protect Rica” shpk se “ Ne DST-ne e kesaj procedure Shtojca 8 Kriteret e Pergjithshme te Pranimi/Kualifikimit ne Seksionin Kapaciteti Teknik shpreheni: Operatori ekonomik duhet te kete ne pronesi minimum 2 Arme Brezi te vertetuara me Autorizim per Blerie Arme nga Dreitoria Pergjithshme e Policise. Kontrate Shitblerie Armesh me shoqeri te Licensuar shoqeruar me nr serial te armeve. Faturat Tatimore dhe Mandat pagesat e Bankes. Duke iu referuar kriterit te vendosur nga ana juaj dhe mbeshtetur ne ndryshimet ligjore per rregjimin e armeve dhe rekomandimeve e udhezimeve te A.P.P-se e K.P.P-se, sqarojme se te gjitha kerkesat e mesiperme jane jo ligjore dhe jane hequr nga DST e procedurave te sherbimit privat te ruajtjes prej disa vitesh. Per sa thame me lart i kerkojme Autoritetit Kontraktor te heqe kerkesat e paraqitjes se dokumentacionit ligjor te posedimit te armeve ne teresi, ne perputhje me ndryshimet ligjore ne fuq”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, i dokumentave të tenderit, është kërkuar si vijon:

Operatori ekonomik duhet të kete ne pronesi minimum 2 Arme Brezi te vertetuara me:

- Autorizim per Blerje Arme nga Drejtoria Pergjithshme e Policise.
- Kontrate Shitblerje Armesh me shoqeri te Licensuar shoqeruar me nr serial te armeve.
- Faturat Tatimore dhe Mandat pagesat e Bankes.

III.3.2. Në nenin 46 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.3.2. Në Ligjin Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, neni 27 “Përgjegjësitë e punonjësit të shërbimit”, pika “c” parashikon se:

[...] Punonjësi i shërbimit privat të sigurisë fizike vepron me cilësinë e rojës, të trupprojës, të operatorit, të shoferit, si mbajtës i qenit, si dhe të përgjegjësit të shërbimit dhe ka këto përgjegjësi: c) të mbajë, sipas rregullores, armatimin personal e pajisjet e shërbimit, të përdorë uniformën, shenjat dhe simbolet e SHPSF-së, vetëm gjatë kryerjes së detyrës, si dhe të përdorë armën sipas legjislacionit në fuqi”

Ndërsa sipas nenit.34, po këtu, thuhet se “[...] në veprimtarinë e sigurisë fizike të drejtën e mbajtjes së armëve të zjarrit dhe municionit, vetëm gjatë kryerjes së detyrës, e kanë drejtuesi teknik dhe punonjësit e shërbimit. Lloji i armëve të zjarrit dhe municionit të tyre që jepen për mbajtje, miratohen nga Policia e Shtetit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi [...]”

III.3.3. Referuar ligjit 74/2014, datë 10.07.2014 “Për armët”, neni 5 “Kategorizimi i armëve” parashikon shprehimisht se: “1. Armët, sipas këtij ligji, kategorizohen si më poshtë:

1.2. Armët e kategorisë “B” janë:

a) armët e shkurtra të zjarrit gjysmautomatike apo vetërimbushëse (B1);

b) armët e zjarrit të shkurtra për një qitje, me ndezje qendrore (B2);

c) armët me ndezje anësore të shkurtra për një qitje, me gjatësi të përgjithshme më të vogël se 28cm; (B3);

ç) armët e zjarrit të gjata gjysmautomatike, me gushë ose fole për fishekë, që mund të mbajnë më tepër se tre fishekë (B4);

d) armët e zjarrit të gjata gjysmautomatike, me gushë ose fole për fishekë, që mund të pranojnë deri në tre fishekë. Kur mbushësi i tyre ndërrohet, këto armë mund të konvertohen, me ndihmën e një mjeti të zakonshëm, dhe të pranojnë më tepër se tre fishekë (B5);

dh) armët e zjarrit të gjata gjysmautomatike ose me përsëritje, me tytë të pavjaskuar, të gjatë deri në 60 cm (B6);

e) armët e zjarrit pneumatike, me energji të predhës mbi 7,5 J dhe kalibër mbi 4,5 mm (B7); [...]” Gjithashtu, në nenin 7 “E drejta e pronësisë mbi armët”, të ligjit të sipërcituar parashikohet shprehimisht se:

“1. Armët e kategorisë “A”, në kuptim të këtij ligji, janë vetëm pronë e shtetit, me përjashtim të armëve të zjarrit të gjuetisë dhe ato sportive me vjaska dhe të pajisura me shënjestër optike. 2. Armët e kategorive “B”, “C” dhe “D”, në kuptim të këtij ligji, mund të jenë në pronësi private e shtetërore.

3. Veprimet juridike për kalimin e pronësisë ose të të drejtave të tjera mbi armët kryhen në përputhje me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

4. Për sa nuk parashikohet në këtë ligj, zbatohen dispozitat e Kodit Civil.”

Ndërsa neni 8 i ligjit “Regjimi juridik për kategoritë e armëve” përcaktohet se:

“[...] Për armët e përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji, ka regjim të veçantë juridik ,duke respektuar përfshirjen në kategoritë e ndryshme, si më poshtë:

1. Në kategorinë “A” përfshihen armë, të cilat nuk lejohen të përdoren dhe për të cilat nuk lëshohet autorizim, me përjashtim të armëve të zjarrit të gjuetisë dhe ato sportive me vjaska, të pajisura me shënjestër optike, që në kuptim të këtij ligji nuk janë të ndaluara. Për këto armë, pajisen me autorizim nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit, ata shtetas shqiptarë ose të huaj që vërtetojnë aftësinë e ushtrimit të sportit të qitjes profesioniste ose gjuetisë, sipas vërtetimit/lejes përkatëse nga ministria përgjegjëse për sportet ose ajo për mjedisin.

2. Në kategorinë “B” përfshihen armë, për të cilat lëshohet autorizim sipas këtij rregulli:

a) për armët e kategorisë “B1”, pajisen me autorizim personat që për shkak të detyrës shtetërore ose të rrethanave personale të veçanta janë të ekspozuar ndaj rrezikut për jetën

dhe u njihet e drejta e mbrojtjes së veçantë, sipas legjislacionit në fuqi, personat që plotësojnë kriteret për mbajtjen e armës, si dhe ata të cilëve për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së sigurisë private u lind e drejta e mbajtjes së armës, sipas këtij ligji;

b) për armët e kategorisë “B4”, pajisen me autorizim personat që për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së sigurisë private, u lind e drejta e mbajtjes së armës, sipas dispozitave të këtij ligji.

[...].”

III.3.4. Komisioni gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.3.5. Referuar bazës ligjore sa më sipër përcaktohet qartë se çdo person i pajisur me certifikatën si punonjës shërbimi për ruajtjen dhe sigurinë fizike, ka të drejtën për përdorimin edhe të armës së zjarrit. Në këtë kontekst, çdo person i pajisur me leje/certifikatën si punonjës shërbimi, ka të drejtë për përdorimin e armës së zjarrit. Komisioni gjykon se kriteret lidhur me armatimin duhet të hartohen nga autoriteti kontraktor duke mbajtur në vëmendje legjislacionin mbi armët që i japin të drejtën, çdo operatori ekonomik që ushtron aktivitet në fushën e shërbimit të sigurisë së ruajtjes fizike, të pajisjen me armatim personal sipas ligjit, duke dëshmuar në procedurat prokuruese plotësimin e kapaciteteve lidhur me armatimin. Në rast se autoriteti kontraktor ka dyshime lidhur me plotësimin e këtij kriteri mund të bëjë verifikimet përkatëse pranë organeve kompetente, sic është Drejtoria e Policisë së Qarkut, e cila ndjek dhe monitoron aktivitetin e shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këtë kontekst autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit të sipërcituar, duke hequr kriterin lidhur me paraqitjen e dokumentacionit ligjorë të posedimit të armëve, pasi vërtetueshmëria mbi zotërimi i tyre verifikohet nga Drejtoria e Policisë së Qarkut përkatës dhe pasqyrohet në vërtetimet përkatëse të lëshuara nga ky institucion, i cili monitoron edhe veprimtarinë e SHPSF-ve në njësitë administrative përkatëse ku ato ushtrojnë aktivitetin e tyre. Për këtë arsye, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, autoriteti kontraktor në vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit duhet të bazohet në parashikimet ligjore, në funksion të arritjes së qëllimit të tij.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Guard & Protect Rica” shpk se “Ne DST-ne e kesaj procedure shtojca 8 Kriteret e Pergjithshme te Pranimi/Kualifikimit ne Seksionin Kapaciteti Teknik pika 2 ku shprehet se duhet te ketë grup te gatshe 24 ne 24 ore për nënkategorinë 1.3.A i specifikuar në performancën e subjektit, jo më pak se 5 punonjës shërbimi, si dhe pika 9 ku shprehet se: Specifikimet per Sistemet e Alarmit: Operatori ekonomik duhet te kete te instaluar salle te monitorimit per marrjen e sinjaleve ne

raste zjarri, tymi ne objekt. Te disponoje dhe te kete ne gadishmeri grup per verifikimin e sinjaleve dhe te siguroje prezencen e tij ne objekt. Te disponoj 1 mjet per levizjen e grupit te verifikimit te sinjalit Objekti i kesaj kontrate eshte sherbim ruajtje dhe jo verifikim sinjalesh me grupe te gatshme. Gjithashtu edhe fondi limit eshte parashikuar per sherbim ruajtje te objekteve dhe jo per verifimi te objekteve me sinjal alarmi dhe grupe te gatshme. Ndaj gjykojme se kriteret e mesiperme nuk kane lidhje me proceduren ne fjale kjo duke iu referuar fondit limit objektit te kontrates por edhe specifikimeve teknike e Formularit te Ofertes ku ne asnje rast ne keto elemente thelbesore nuk eshte percaktuar se sherbimi do te kryhet ne dy menyra ruajtje e verifikim sinjalesh. Per sa thame me lart i kerkojme autoritetit kontraktor te heqe ne total kerkesat e pikes 9 ne respekt e zbatim te legjislacionit ne fuqi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2 dhe 9 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. Vërtetim performance nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Lezhe leshuar ne vitin 2019 e cila duhet te permbaje te dhenat

- listen emerore te punonjesve te sherbimit te certifikuar jo me pak se 5 punonjes, dhe vleshmerine e ketyre certifikatave – daten e certifikimit (daten e leshimit),
- pergjegjes sherbimi jo me pak se 1 punonjes
- grup i gatshem 24 ne 24 ore për nënkategorinë 1.3.A i specifikuar në performancën e subjektit, jo më pak se 5 punonjës shërbimi.
- Qender Kontrollit te Sherbimit ne funksion 24 ore/ 7 dite ne Qarkun e Lezhës me jo me pak se 5 punonjes/operator, shoqeruar me Akt Miratimimin e Qendres Kontrollit nga DVP Lezhe
- automjete sherbimi jo me pak se 1
- nuk ka mase administrative
- nuk ka ngjarje te ndodhura

9. Specifikimet per Sistemet e Alarmit

Operatori Ekonomik duhet te kete te instaluar Sallë të Monitorimit për marrjen e sinjale ne raste zjarri, tymi ne objekt.

Të disponoj dhe të ketë në gadishmëri Grup për Verifikimin e sinjalëve dhe të siguroj prezencën e tij ne objekt.

Të disponoj 1 mjet për lëvizjen e grupit të verifikimit të sinjalit.

III.4.2. Në shtojcën 8 “Specifikimet Teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si vijon:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Kontrata do te lidhet per 4.98 (kater presje nentedhejte e tete) punonjes per nje periudhe 12 Mujore nga moment I nenshkrimit te Kontrates.

Vlera e ofertes duhet te paraqitet ne lek/me muaj per punonjes sherbimi.

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Objektet e Drejtorise se Sherbimit Spitlor Kurbin qe kerkohen te ruhen nga (SH.P.S.F) jane objekti I godines se Drejtorise se Sherbimit Spitlor Kurbin me sherbim 24 ore .
2. Te mbuloje te gjitha shpenzimet si paga te rojeve, sigurimet shoqerore te personelit te punesuar nga ana e tij per ruajtjen e objekteve, shpenzimet per uniformat, armatime, nderlidhje si dhe gjithe kompensimet e tjera te njohura me ligj.
3. Sigurimi i rendit dhe qetesise ne objektin qe ruan, duke parandaluar demtimin e prones se punedhenesit ose vjedhjen e saj.
4. Te ushtroje kontroll te here pas hershem te personave qe hyjne ne teritorin e objektit qe ruhen si dhe automjeteve qe qarkullojne ne teritorin e saj.
5. Te kerkoje zbatimin e rregullave te percaktuara nga punedhenesi si dhe rregulloreve te brendshme te nxjera nga ky i fundit te cilat do te jene pjese perberese e kesaj kontrate.
6. Te informoje regullisht titullarin e institucionit per shkelje te konstatuara.
7. Sipermarresi mban pergjegjesi per demtimet apo vjedhjet qe mund te ndodhin ne territorin e objektit qe ruhet nga ana e tij kur keto vijne si rezultat I mungeses se vigjilences te rojeve dhe mosorganizimit temire te sherbimit. Ne keto raste sipermarresi detyrohet te beje cdemtimin e pasurise se vjedhur apo demtuar ne masen 100% te vleres se demtuar.
8. Demtimin e vlerave materiale gjate shoqerimit prej tyre duke bere cdemtimin 100% te vleres se demtuar si dhe pergjegjesine per jeten e personave qe bejne shoqerimin e mjeteve monetare.
9. Gjate sherbimit punonjesi do te jete me uniformen e caktuar dhe me karten e identitetit personal per cdo punonjes.
10. Cdo vendroje do te jete i pajisur me armatimin e domosdoshem dhe me pajisjet ndihmese qe percaktohen ne ligjet dhe udhezimet perkatese.

III.4.3. Në shtojcën 11 “Termat e Referencës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaltohet si më poshtë:

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Per nje periudhe 12 –Muaj nga momenti i lidhjes se Kontrates.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Skicimet, paprametrat teknik etj:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Kontrata do te lidhet **per 4.98 (kater presje nentedhejte e tete) punonjes per nje periudhe 12 Mujore nga moment I nenshkrimit te Kontrates.**

Vlera e ofertes duhet te paraqitet ne lek/me muaj per punonjes sherbimi

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

*1. Objektet e Drejtorise se Sherbimit Spitlor Kurbin qe kerkohen te ruhen nga (SH.P.S.F) jane objekti I godines se Drejtorise se Sherbimit Spitlor Kurbin me sherbim **24 ore** .*

Detyrat:

- 2. Te mbuloje te gjitha shpenzimet si paga te rojeve, sigurimet shoqerore te personelit te punesuar nga ana e tij per ruajtjen e objekteve, shpenzimet per uniformat, armatime, nderlidhje si dhe gjithë kompensimet e tjera te njohura me ligj.*
- 3. Sigurimi i rendit dhe qetesise ne objektin qe ruan, duke parandaluar demtimin e prones se punedhenesit ose vjedhjen e saj.*
- 4. Te ushtroje kontroll te here pas hershem te personave qe hyjne ne teritorin e objektit qe ruhen si dhe automjeteve qe qarkullojne ne teritorin e saj.*
- 5. Te kerkoje zbatimin e rregullave te percaktuara nga punedhenesi si dhe rregulloreve te brendshme te nxjera nga ky i fundit te cilat do te jene pjese perberese e kesaj kontrate.*
- 6. Te informoje regullisht titullarin e institucionit per shkelje te konstatuara.*
- 7. Sipermarresi mban pergjegjesi per demtimet apo vjedhjet qe mund te ndodhin ne territorin e objektit qe ruhet nga ana e tij kur keto vijne si rezultat I mungeses se vigjilences te rojeve dhe mosorganizimit temire te sherbimit. Ne keto raste sipermarresi detyrohet te beje cdemtimin e pasurise se vjedhur apo demtuar ne masen **100%** te vleres se demtuar.*
- 8. Demtimin e vlerave materiale gjate shoqerimit prej tyre duke bere cdemtimin **100%** te vleres se demtuar si dhe pergjegjesine per jeten e personave qe bejne shoqerimin e mjeteve monetare.*
- 9. Gjate sherbimit punonjesi do te jete me uniformen e caktuar dhe me karten e identitetit personal per cdo punonjes.*
- 10. Cdo vendroje do te jete i pajisur me armatimin e domosdoshem dhe me pajisjet ndihmese qe percaktohen ne ligjet dhe udhezimet perkatese.*
- 11. Pervec specifikimeve te mesiperme, marredheniet me te detajuara midis SH.P.S.F dhe Drejtorise se DSHS-Kurbin do te jepen ne rregulloren e sherbimit qe do te jete pjese perberese e kontrates si dhe zbatimin e Ligjit nr **75/2014** date 10.07.2014”Per sherbimin privat te Sigurise “.*

III.4.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, 6 kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.4.5. Në nenin 1 “Objekti dhe Qëllimi” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: 1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore. 2. Qëllimi i këtij ligji është: b) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.4.6. Në nenin 20 “Mosdiskriminimi” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”.

III.4.7. Në nenin 23 pika 1, 2, “Specifikimet teknike” të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: 1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. III.7.2.8. Në nenin 28, pika 1 “Kontratat e shërbimeve” të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet”.

III.4.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Referuar rregullave të prokurimit publik si më sipër cituar, natyra e shërbimit duhet të shprehet qartë në termat e referencës dhe specifikimet teknike, të cilat duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Për aq kohë sa vete autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar në asnjë kriter të dokumentave standarte të tenderit dhe as në specifikimet teknike dhe termat e referencës të hartuara prej tij asnjë të dhënë apo informacion lidhur me përdorimin e sinjaleve të alarmit për shërbimin e kërkuar, Komisioni gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor sipas së cilës operatori ekonomik duhet të kete te

instaluar salle te monitorimit per marrjen e sinjaleve ne raste zjarri, tymi ne objekt, te disponoje dhe te kete grup te gatshem 24 ne 24 ore per nënkategorinë 1.3.A i specifikuar në performancën e subjektit, jo më pak se 5 punonjës shërbimi dhe te siguroje prezencen e tij ne objekt, si dhe te disponoj 1 mjet per levizjen e grupit te verifikimit te sinjalit, është një kriter i ekzagjeruar dhe nuk përputhet me natyrën e kontratës objekt prokurimi, ndaj dhe autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e dokumentave të tenderit, duke i hequr këto kritere.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Guard & Protect Rica” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me Nr. REF-36051-09-16-2019, me objekt “Shërbim Privat të Sigurisë Fizike të DSHS-Kurbin”, me fond limit 3,352,000 lekë pa tvsh, publikuar më datë 17.09.2019 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kurbin.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentat e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Guard & Protect Rica” shpk.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1550 Protokolli, Datë 01.10.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

NënKryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha